

Përkthim jozyrtar i bërë nga Qendra Shqiptare për të Drejtën Ndërkombëtare (ACIL), mbështetur nga Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (Fondacioni IRZ).



ALBANIAN CENTER  
OF  
INTERNATIONAL LAW

DEUTSCHE STIFTUNG FÜR  
INTERNATIONALE RECHTLICHE  
ZUSAMMENARBEIT E.V.



Stabilitätspakt für Südosteuropa  
Gefördert durch Deutschland  
Stability Pact for South Eastern Europe  
Sponsored by Germany

## 29.

### KONVENTA MBI AKSESIN NDËRKOMBËTAR NË DREJTËSI *E miratuar më 25 tetor 1980*

Shtetet nënshkruese të kësaj Konvente,

Duke dëshiruar të lehtësojnë aksesin ndërkombëtar në drejtësi,

Kanë vendosur të përfundojnë një konventë për këtë qëllim dhe kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme:

#### KAPITULLI I NDIHMA LIGJORE

##### Neni 1

Shtetasit e çdo shteti kontraktues dhe personat që kanë vendbanimin e zakonshëm në ndonjë prej shteteve kontraktuese kanë të drejtën e ndihmës ligjore në seancat gjyqësore për çështjet civile dhe tregtare në çdo shtet kontraktues me të njëjtat kushte sikur të ishin shtetas dhe banorë të zakonshëm të atij shteti.

Personat ndaj të cilëve nuk zbatohet paragrafi 1, por që kanë pasur më parë vendbanimin e zakonshëm në një shtet kontraktues, në të cilin do të fillojnë ose kanë filluar procedurat gjyqësore, do tu jepet, megjithatë, e drejta e ndihmës ligjore, siç është parashikuar në paragrafin 1, nëse shkaku i padisë ka lindur brenda vendbanimit të mëparshëm të zakonshëm të tyre në atë shtet.

Në shtetet ku sigurohet ndihmë ligjore për çështjet administrative, sociale apo fiskale, do të zbatohen dispozitat e këtij neni, ndaj çështjeve të depozituara në gjykatat kompetente në çështje të tilla.

##### Neni 2

Neni 1 do të zbatohet ndaj konsulencës ligjore, me kusht që personi i cili kërkon këtë asistencë të jetë i pranishëm në shtetin ku kërkohet konsulenca.

##### Neni 3

Çdo shtet kontraktues do të caktojë një autoritet qendror për të pranuar dhe vendosur lidhur me kërkesat që dorëzohen për asistencë ligjore në bazë të kësaj Konvente.

Shtetet federale dhe shtetet të cilat kanë më shumë se një sistem ligjor, mund të caktojnë më shumë se një Autoritet Qendror. Nëse Autoriteti Qendror, të cilit i është dërguar kërkesa nuk është kompetent për ta shqyrtuar atë, do t'ia kalojë çdo autoriteti tjetër qendror të shtetit kontraktues që është kompetent për ta shqyrtuar atë.

#### **Neni 4**

Çdo shtet kontraktues do të caktojë një ose me shumë autoritete transmetuese për qëllimin transmetimit të kërkesave për asistencë ligjore tek Autoriteti Qendror përkatës në shtetin e kërkuar.

Kërkesat për asistencë ligjore do të transmetohen, pa ndërhyrjen e ndonjë autoriteti tjetër, në formën e modelit që i bashkëlidhet kësaj Konvente.

Asgjë e parashikuar nga ky nen nuk do të pengojë që një kërkesë të dërgohet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

#### **Neni 5**

Në rast se kërkuesi i asistencës ligjore nuk është i pranishëm në shtetin e kërkuar, ai mund t'ia dorëzojë kërkesën e tij autoritetit transmetues në shtetin kontraktues ku ai ka vendbanimin e zakonshëm, pa paragjykuar mjete të tjera të mundshme për dorëzimin e kërkesës tek autoriteti kompetent në shtetin e kërkuar.

Kërkesa do të paraqitet në formën e modelit që i bashkëngjitet kësaj Konvente dhe do të shoqërohet me të gjitha dokumentet e nevojshme, pa cenuar të drejtën që ka shteti i kërkuar për të kërkuar më shumë të dhëna ose dokumente, në rastet kur është e nevojshme.

Çdo shtet kontraktues mund të deklarojë se Autoriteti Qendror pritës do të pranojë kërkesa që dorëzohen nga kanale apo metoda të tjera.

#### **Neni 6**

Autoriteti transmetues do të asistojë kërkuessit, duke i siguruar që kërkesa është e shoqëruar me të gjitha informacionet dhe dokumentet e njohura prej tij që janë të nevojshme për shqyrtimin e kërkesës. Ai do të sigurojë që kërkesat formale janë përmbushur.

Nëse autoriteti transmetues vlerëson që kërkesa është në mënyrë të qartë e pabazë, ai mund të refuzojë transmetimin e kërkesës.

Ai do të asistojë kërkuessin që të sigurojë përkthimin e dokumenteve pa pagesë, atëherë kur kjo ndihmë është e nevojshme.

Ai do t'i përgjigjet kërkesës për informacion të mëtejshëm nga Autoriteti Qendror pritës në shtetin e kërkuar.

#### **Neni 7**

Kërkesa, dokumentet mbështetëse dhe çdo njoftim në përgjigje të kërkesave për informacion të mëtejshëm do të jenë në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të shtetit të kërkuar, ose të jenë shoqëruar me një përkthim në një prej atyre gjuhëve.

Megjithatë, në rastin kur në shtetin kërkuess nuk është e mundshme të sigurohet një përkthim në gjuhën e shtetit të kërkuar, ky i fundit do të pranojë dokumentet ose në gjuhën angleze ose në gjuhën frënge, ose dokumentet të shoqëruara me një përkthim në një prej atyre dy gjuhëve.

Njoftimet që dalin nga Autoriteti Qendror pritës mund të përpilohen në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të shtetit të kërkuar, ose në gjuhën angleze apo në gjuhën frënge. Megjithatë, nëse kërkesa e dërguar nga autoriteti transmetues është në gjuhën angleze ose në gjuhën frënge, ose shoqërohet me një përkthim në një prej këtyre gjuhëve, njoftimet e nxjerra nga autoriteti qendror pritës të do të bëhen, gjithashtu, në një prej tyre.

Shpenzimet e përkthimit lidhur me aplikimin e paragrafëve të mësipërm do të mbulohen nga shteti i kërkuar, vetëm se çdo përkthim i bërë në shtetin e kërkuar nuk do të sjellë ndonjë pretendim për rimbursim nga ana e atij shteti.

#### **Neni 8**

Autoriteti Qendror pritës do të vendosë për kërkesën ose do të marrë masa të tilla të nevojshme për marrjen e vendimit nga një autoritet kompetent në shtetin e kërkuar.

Autoriteti Qendror pritës do t'ia transmetojë kërkesat për detaje të mëtejshme autoritetit transmetues dhe do ta njoftojë atë për çdo vështirësi lidhur me shqyrtimin e kërkesës dhe të vendimin të marrë.

#### **Neni 9**

Në rastin kur kandidati për asistencë ligjore nuk banon në një shtetin kontraktues, ai mund ta dorëzojë kërkesën e tij nëpërmjet kanaleve konsullore, pa paragjykuar ndonjë mjet tjetër në dispozicion për t'ia dorëzuar kërkesën e tij autoritetit kompetent në shtetin e kërkuar.

Çdo shtet kontraktues mund të deklarojë se Autoriteti Qendror pritës i tij do të pranojë kërkesat që dorëzohen nga kanale apo mënyra të tjera.

#### **Neni 10**

Të gjitha dokumentet e dërguara sipas këtij kapitulli janë të përjashtuara nga legalizimi ose çdo formalitet tjetër analog.

#### **Neni 11**

Nuk do të ketë pagesë për transmetimin, marrjen ose dhënien e vendimit për kërkesat për asistencë ligjore sipas këtij kapitulli.

#### **Neni 12**

Kërkesat për asistencë ligjore do të shqyrtohen në afat kohor të shpejtë.

#### **Neni 13**

Në rastet kur asistenca ligjore garantohet në përputhje me nenin 1, shërbimi për dokumentet në çdo shtet tjetër kontraktues në ndjekje të procedurave të personave që kanë marrë asistencë ligjore, nuk do të bëhet me pagesë, pavarësisht nga mënyra sesi kryhet shërbimi. E njëjta gjë mund të thuhet për letërporositë dhe raportet e hetimit social, përveç tarifës së pagesës për ekspertët dhe përkthyesit.

Në rastet kur një person ka marrë asistencë ligjore në përputhje me nenin 1 për procedurat që kryhen në një shtet kontraktues dhe një vendim është marrë në këto procedura, ai do të ketë të drejtën e asistencës ligjore, pa shqyrtuar më tej rrethanat e tij, në çdo shtet kontraktues ku ai përpiqet të sigurojë njohjen apo zbatimin e atij vendimi.

**KAPITULLI II**  
**GARANCIA PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE GJYQËSORE**  
**DHE ZBATIMI I URDRHAVE LIDHUR ME TO**

**Neni 14**

Nuk mund të kërkohet asnjë garanci, hipotekë apo depozitë e çdo lloji të caktuar, nga persona (duke përfshirë persona ligjorë) të cilët kanë vendbanimin e zakonshëm në një shtet kontraktues dhe janë paditës ose palë që ndërhyjnë në seanca gjyqësore, ose në gjykatat e një shteti tjetër kontraktues vetëm për shkak të kombësisë së huaj ose për shkak se nuk kanë jetuar apo nuk kanë qenë banorë në shtetin ku kanë filluar procedurat.

I njëjti rregull do të zbatohet për çdo pagesë që kërkohet prej paditësve apo palëve ndërhyrëse si garanci për tarifën gjyqësore.

**Neni 15**

Do të zbatohet pa taksë në çdo shtet kontraktues, urdhri për pagesën e shpenzimeve gjyqësore të kryera në një nga shtetet kontraktuese ndaj çdo personi të çliruar nga kërkesat për garanci, hipotekë, depozitë ose pagesë duke u mbështetur në nenin 14 ose të ligjit të shtetit ku kanë filluar procedurat për zbatimin e urdhrat që i jep të drejtë personave të përfitojnë prej tij.

**Neni 16**

Çdo shtet kontraktues do të caktojë një ose më shumë autoritete transmetuese, me qëllim që të dërgojnë kërkesat tek Autoritet Qendrorë përkatëse në shtetin e kërkuar për të vënë në praktikë urdhrat për të cilat zbatohet neni 15.

Çdo shtet kontraktues do të caktojë një Autoritet Qendror për të pranuar këto kërkesa dhe të marrë hapat e duhura për të siguruar që të merret një vendim përfundimtar për to.

Shtetet federale dhe shtetet të cilat kanë më shumë se një sistem ligjor mund të caktojnë më shumë se një Autoritet Qendror. Në rast se autoriteti qendror, të cilit i është dërguar një kërkesë, nuk është kompetent që ta marrë atë në shqyrtim, atëherë ai do t'ia dërgojë kërkesën cilitdo Autoriteti Qendror tjetër në shtetin e kërkuar që ka kompetencat e duhura.

Kërkesat në bazë të këtij neni do të transmetohen pa ndërhyrjen e ndonjë autoriteti tjetër, pa paragjykuar ndonjë aplikim që transmetohet me rrugë diplomatike.

Asgjë në këtë nen nuk do të pengojë që kërkesat të bëhen drejtpërsëdrejti nga persona që gëzojnë të drejtën e përfitimit nga ky urdhër, me përjashtim të rasteve kur shteti i kërkuar ka deklaruar se nuk do t'i pranojë kërkesat e bëra në këtë mënyrë.

**Neni 17**

Çdo kërkesë sipas nenit 15 do të shoqërohet nga:

- a. një kopje origjinale të pjesës përkatëse të vendimit me emrat dhe cilësitë e palëve dhe të urdhrat të pagesës së kostove ose shpenzimeve;
- b. çdo dokument i nevojshëm që provon se vendimi nuk i nënshtrohet më formave të zakonshme të rishikimit në shtetin e origjinës dhe që duhet të zbatohet në atë shtet;
- c. një përkthimin, i certifikuar si i vërtetë, i dokumenteve të sipërpërmendura në gjuhën e shtetit kërkuar, nëse ato nuk janë në atë gjuhë.

Vendimet për aplikimet do të merren pa seancë gjyqësore dhe autoriteti kompetent në shtetin kërkues do të kufizohet në shqyrtimin nëse dokumentet e kërkuara janë paraqitur. Në bazë të kërkesës së kërkuesit, ai autoritet do të përcaktojë shumën e shpenzimeve të vërtetimit, përkthimit dhe certifikimit, të cilat do të trajtohen si shpenzime dhe kosto të procedurave. Nuk mund të kërkohet asnjë im apo formalitet analog.

Nuk ketë asnjë të drejtë apelimi ndaj vendimeve të autoriteteve kompetente, përveç rastit kur ka përputhje me ligjin e shtetit të kërkuar.

### **KAPITULLI III KOPJE TË REGJISTRIMEVE DHE VENDIMEVE**

#### **Neni 18**

Shtetasit e çdo shteti kontraktues dhe personat me vendbanim të zakonshëm në çdo shtet kontraktues, mund të marrin në çdo shtet tjetër kontraktues, me të njëjtat terma dhe kushte si shtetasit e tij, kopje ose ekstrakte nga regjistrimet në regjistrat publikë dhe vendimet lidhur me çështjet civile ose tregtare dhe mund t'i marrin ato dokumente të legalizuara, kur është e nevojshme.

### **KAPITULLI IV NDALIMI FIZIK DHE SJELLJA E MIRË**

#### **Neni 19**

Arrestimi dhe ndalimi, qoftë si mjet për zbatimin e ligjit ose si masë parandaluese, nuk do të përdoret si për çështjet civile, ashtu edhe për ato tregtare kundër shtetasve të një shteti kontraktues ose personave rezidentë në atë shtet kontraktues në rrethana kur ato nuk mund të zbatohet ndaj shtetasve të shtetit ku kryhet ndalimi ose arrestimi. Çdo fakt që mund të lidhet me kërkesat e një shtetas banues i zakonshëm i atij shteti për të fituar lirinë nga arresti ose ndalimi mund të kërkohet me të njëjtin efekt nga një shtetas i të njëjtit shtet kontraktues ose nga një person banues i zakonshëm në një shtetin kontraktues, edhe nëse një fakt i tillë mund të ketë ndodhur jashtë atij shteti.

#### **Neni 20**

Një personi, i cili është shtetas ose banor i zakonshëm në një shtet kontraktues dhe që thërritet në emër nga një gjykatë ose trup gjykues në një tjetër shtet kontraktues, ose nga një palë, me leje të gjykatës ose trupit gjykues, në mënyrë që të paraqitet si dëshmitar ose ekspert gjatë procedurave që zhvillohen në atë shtet, nuk do të jetë përgjegjës para ndjekjes penale ose arrestimit, ose t'i nënshtrohet çdo lloj kufizimi tjetër të lirive të tij personale, në territorin e atij shteti, për sa i përket çdo akti apo dënimi që mund të ngjasë para mbërritjes së tij në atë shtet.

Imuniteti i siguruar në paragrafin e mësipërm do të fillojë shtatë ditë para datës së caktuar për seancën e dëgjimit të dëshmitarit ose ekspertit dhe do të mbarojë kur dëshmitari ose eksperti që ka pasur, për një periudhë prej shtatë ditësh të njëpasnjëshme që nga data kur ai është lajmëruar nga autoritetet gjyqësore që prezenca e tij nuk është më e nevojshme, një mundësi që të largohet, por që megjithatë ka qëndruar në atë territor, ose e ka lënë atë, është kthyer vullnetarisht.

## **KAPITULLI V DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 21**

Pa çënuar dispozitat e nenit 22, asgjë në këtë Konventë nuk do të interpretohet si kufizim i ndonjë të drejte për sa i përket çështjeve të trajtuara nga kjo Konventë, që mund t'i akordohen një personi sipas ligjit të çdo shteti kontraktues, ose sipas çdo konvente tjetër në të cilën është ose mund të bëhet palë.

### **Neni 22**

Ndërmjet palëve të kësaj Konvente, të cilat janë, gjithashtu, palë të një apo dy konventave mbi procedurat civile të nënshkruara në Hagë më 17 korrik 1905 dhe 1 mars 1954, kjo Konventë do të zëvendësojë nenet nga 17 deri tek 24 të Konventës së vitit 1905, ose nenet 17 deri tek 26 të Konventës së vitit 1954, edhe nëse është bërë rezerva e parashikuar në paragrafin 2 c) të nenit 28 të kësaj Konvente.

### **Neni 23**

Marrëveshjet plotësuese ndërmjet palëve të Konventave së vitit 1905 dhe 1954, do të konsiderohen si njësoj të zbatueshme ndaj kësaj Konvente, në masën që ato janë në përputhje me të, me përjashtim të rastit kur palët bien dakord për të kundërtën.

### **Neni 24**

Një shtet kontraktues mundet që me anë të një deklaratë të specifikojë një gjuhë apo gjuhët, përveç atyre që përmenden në nenet 7 dhe 17, në të cilat mund të përpilohen ose përkthehen dokumentet e dërguara tek Autoriteti Qendror i tij.

### **Neni 25**

Një shtet kontraktues, i cili ka më shumë se një gjuhë zyrtare dhe nuk mundet, për arsye të ligjeve të brendshme, të pranojë për të gjithë territorin e tij dokumentet e përmendura në nenet 7 dhe 17 të përpiluara në një nga këto gjuhë, do të specifikojë, me anë të një deklaratë, gjuhën në të cilën dokumente ose përkthime të tilla do të përpilohen për t'u paraqitur në zonat e specifikuar të territorit të tij.

### **Neni 26**

Në rast se një shtet kontraktues ka dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore lidhur me çështje që trajtohen në këtë Konventë, mundet që, në momentin e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit, të deklarojë që kjo Konventë të shtrihet në të gjitha njësitë territoriale, ose vetëm te njëra apo më shumë se një prej tyre, dhe mund ta ndryshojë atë deklaratë me anë të një deklaratë tjetër në çdo kohë.

Çdo deklaratë e tillë do t'i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Hollandës dhe do të cilësojë shprehimisht njësitë territoriale në të cilat zbatohet Konventa.

### **Neni 27**

Në rastin kur një shtet kontraktues ka një sistem qeverisjeje, sipas të cilit pushteti ekzekutiv, gjyqësor dhe legjislativ shpërndahet ndërmjet autoriteteve qendrore dhe autoriteteve të tjera brenda atij shteti, nënshkrimi ose ratifikimi i saj, pranimi ose miratimi, ose aderimi tek kjo Konventë, ose bërja e çdo

deklarate sipas nenit 26, nuk sjell asnjë pasojë për sa i përket shpërndarjes së brendshme të pushteteve brenda atij shteti.

## **Neni 28**

Çdo shtet kontraktues mund të rezervojë të drejtën, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, që të përjashtojë zbatimin e nenit 1 në rastin e personave që nuk janë shtetas të një shtetit kontraktues, por që janë banorë të zakonshëm në një shtet kontraktues, ndryshe nga shteti që bën rezervën ose që kanë pasur më parë vendbanimin e zakonshëm në shtetin që ka bërë rezervën, në rast se nuk ka reciprocitet në trajtim ndërmjet shtetit që ka bërë rezervën dhe shtetit, shtetësinë e të cilit kanë kërkuar asistencën ligjore.

Çdo shtet kontraktues, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të rezervojë të drejtën që të përjashtojë:

- a. përdorimin e gjuhës angleze apo frënge, ose të dyjave, sipas paragrafit 2 të nenit 7;
- b. zbatimin e paragrafit 2 të nenit 13;
- c. zbatimin e kapitullit II;
- d. zbatimin e nenit 20.

Në rastin kur një shtet e ka bërë një rezervë:

- e. sipas paragrafit 2 a) të këtij neni, duke përjashtuar përdorimin e gjuhës angleze dhe frënge, çdo shtet tjetër i përfshirë në lidhje me të mund të zbatojë të njëjtin rregull ndaj shtetit që bën rezervën.
- f. sipas paragrafit 2 b) të këtij neni, çdo shtet tjetër mund të refuzojë të zbatojë paragrafin 2 të nenit 13 ndaj personave të cilët janë shtetas apo banues të zakonshëm në shtetin që ka bërë rezervën;
- g. sipas paragrafit 2 c) të këtij neni, çdo shtet tjetër mund të refuzojë që kapitulli II të zbatohet ndaj personave të cilët janë shtetas apo banues të zakonshëm në shtetin që ka bërë rezervën.

Asnjë rezervë tjetër nuk do të lejohet.

Çdo shtet kontraktues në çdo kohë mund të tërheqë rezervën që ka bërë. Tërheqja do t'i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Hollandës. Rezerva do të pushojë efektin në ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas njoftimit.

## **Neni 29**

Çdo shtet kontraktues, në kohën e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit, ose në një datë të mëvonshme, do të informojë Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Hollandës për caktimin e autoriteteve në bazë të neneve 3, 4 dhe 16.

Ai do të informojë, gjithashtu, Ministrinë, kur është e nevojshme, për sa vijon më poshtë:

- a. deklaratat në bazë të neneve 5, 9, 16, 24, 25, 26 dhe 33;
- b. çdo tërheqje ose modifikim të përcaktimeve dhe deklaratave të mësipërme;
- c. tërheqjen e çdo rezerve.

### **Neni 30**

Formularët model që i bashkëngjiten kësaj Konvente mund të amendohen me një vendim të një Komisioni të Posaçëm që mbledhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Konferencës së Hagës, ku do të ftohen të gjitha shtetet kontraktuese dhe shtetet anëtare. Njoftimi i propozimit për mendimin e formularëve do të përfshihet në rendin e ditës së takimit.

Amendamentet e miratuara nga shumica e shteteve kontraktuese të pranishme dhe që votojnë në Komisionin e Posaçëm do të hyjnë në fuqi për të gjitha shtetet kontraktuese ditën e parë të muajit të shtatë kalendarik pas datës së komunikimit të tyre nga Sekretari i Përgjithshëm të gjitha shteteve kontraktuese.

Gjatë periudhës së parashikuar në paragrafin 2, çdo shtet kontraktues, me anë të njoftimit me shkrim drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Hollandës, mund të bëjë një rezervë për sa i përket amendamenteve. Një pala, e cila bën një rezervë të tillë, deri sa rezerva të tërhiqet, do të trajtohet si një shtet jo palë në këtë Konventë në lidhje me atë amendament.

## **KAPITULLI VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 31**

Konventa është e hapur për nënshkrim nga shtetet që kanë qenë anëtare në Konferencën e Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private gjatë sesionit të saj të katërbëdhjetë dhe nga shtetet jo-anëtare, të cilat kanë qenë ftuar të merrnin pjesë për përgatitjen e tij.

Ajo do të ratifikohet, pranohet ose miratohet dhe instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Hollandës.

### **Neni 32**

Çdo shtet tjetër mund të aderojë në Konventë.

Instrumenti i aderimit do të depozitohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Hollandës.

Pranimi do të hyjë në fuqi vetëm për sa i përket marrëdhënieve ndërmjet shtetit aderues dhe atyre shteteve kontraktuese të cilat nuk kanë paraqitur një kundërshtim ndaj pranimit e saj gjatë dymbëdhjetë muajve pas marrjes së njoftimit, të referuar në nënparagrafin 2 të nenit 36. Ky kundërshtim mund të bëhet, gjithashtu, nga shtetet anëtare në kohën kur ratifikojnë, pranojnë ose miratojnë këtë Konventë pas një aderimi. Çdo kundërshtim i tillë do t'i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Hollandës.

### **Neni 33**

Çdo shtet mund të deklarojë në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit që Konventa të shtrihet në të gjitha territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave ai mban përgjegjësi, ose në njërin apo më shumë prej tyre. Një deklaram i tillë do të ketë efekt kur Konventa do të hyjë në fuqi për atë shtet.

Kjo deklaratë, si dhe çdo shtrirje e mëvonshme, do t'i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Hollandës.



### **Neni 34**

Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, sipas nenit 31 dhe 32.

Pas kësaj Konventa hyn në fuqi:

1. për çdo shtet që e ratifikon, pranon, miraton ose aderon më pas në të, ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit;
2. për çdo territor apo njësi territoriale në të cilën është shtrirë Konventa në përputhje me nenin 26 ose 33, ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas njoftimit që i referohet ai nen.

### **Neni 35**

Konventa mbetet në fuqi për pesë vjet që nga data e hyrjes në fuqi, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 34 edhe për shtetet të cilat më pas e kanë ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në të.

Nëse nuk ka pasur denoncim, nënkuptohet që ajo do të rinovohet çdo pesë vjet.

Çdo denoncim do t'i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Hollandës, të paktën gjashtë muaj para skadimit të periudhës pesëvjeçare. Ajo mund të kufizohet në disa territore apo njësi territoriale të caktuara ku zbatohet Konventa.

Denoncimi do të ketë efekt vetëm për shtetet të cilat e kanë njoftuar atë. Konventa do të mbetet në fuqi për shtetet e tjera kontraktuese.

### **Neni 36**

Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Hollandës do të njoftojë shtetet anëtare të Konferencës dhe shtetet që kanë aderuar në përputhje me nenin 32 të saj për sa më poshtë:

1. nënshkrimet dhe ratifikimet, pranimet dhe miratimet e referuara në nenin 31;
2. aderimet dhe kundërshtimet në lidhje me aderimet e referuara në nenin 32;
3. datën kur Konventa hyn në fuqi në përputhje me nenin 34;
4. deklaratat e referuara në nenet 26 dhe 33;
5. rezervat dhe tërheqjet e referuara në nenet 28 dhe 30;
6. informacionin e komunikuar sipas nenit 29;
7. denoncimet e referuara në nenin 35.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Në Hagë, më 25 tetor 1980, në gjuhët angleze dhe frënge, ku të dy tekstet janë njëlloj autentikë, në një kopje të vetme, që do të depozitohet në arkivin e Qeverisë së Mbretërisë së Hollandës dhe prej të cilës do t'i dërgohet një kopje e vërtetuar, përmes kanaleve diplomatike, secilit prej shteteve anëtare që kanë marrë pjesë në përgatitjen e kësaj Konvente gjatë këtij sesi.

## SHTOJCË E KONVENTËS

### FORMULAR PËR TRANSMETIMIN E KËRKESËS PËR ASISTENCË LIGJORE

Konventa mbi Aksesin Ndërkombëtar në Drejtësi  
Nënshkruar në Hagë, më 25 tetor 1980

Identiteti dhe adresa e autoritetit transmetues	Adresa e Autoritetit Qendror pritës
--	--

Autoriteti i nënshkruar transmetues ka nderin t'i dërgojë Autoritetit Qendror pritës kërkesën bashkëngjitur për asistencë ligjore dhe shtojcën e saj (deklaratë lidhur me gjendjen financiare të kërkuarit), për qëllimin kapitullit I të Konventës të lartpërmendur.

Vërejtjet lidhur me kërkesën dhe deklaratën, nëse ka ndonjë:

Vërejtje të tjera, nëse ka ndonjë:

Bërë në ....., më.....  
Firma dhe/ose vula

**FORMULAR BASHKËNGJITUR KONVENTËS**

**KËRKESË PËR ASISTENCË LIGJORE**

**Konventa mbi Aksesin Ndërkombëtar në Drejtësi  
Nënshkruar në Hagë, më 25 tetor 1980**

1. Emri dhe adresa e kërkuesit të asistencës ligjore
2. Gjykata ku ka filluar ose do të fillojnë procedurat gjyqësore (nëse dihet)
3. a. Objekti i çështjes; numri i pretendimeve, nëse janë të zbatueshme  
b. Nëse janë të zbatueshme, lista e dokumenteve plotësuese që kanë të bëjnë me procedurat e filluara ose që pritet të fillojnë\*  
c. Emri dhe adresa e palës kundërshtarë\*
4. Çdo datë ose afat kohor lidhur me procedurat me pasoja ligjore për kërkuesin, që kërkon shqyrtim të përshpejtuar të kërkesës\*
5. Çdo informacion tjetër përkatës\*
6. Bërë në....., më.....
7. Firma e kërkuesit

(\* ) Fshije nëse është e papërshtatshme.

## SHTOJCË E KËRKESËS PËR ASISTENCË LIGJORE

### DEKLARATË PËR GJENDJEN FINANCIARE TË KËRKUESIT

#### *I. Të dhëna personale*

8. Emri (emri vajzërisë, nëse aplikohet)

9. Emri (emrat)

10. Data dhe vendi i lindjes

11. Shtetësia

12. a. Vendbanimi i zakonshëm (data e fillimit të banimit)

b. Vendbanimi i mëparshëm i zakonshëm (data e fillimit dhe mbarimit të banimit)

13. Statusi/gjendja civile (beqar/e, i/e martuar, i/e ve, i/e divorcuar, i/e ndarë)

14. Emri dhe mbiemri i bashkëshortit

15. Emrat, emrat dhe data e lindjes së fëmijëve të kërkuesit

16. Persona të tjerë në ngarkim të kërkuesit

17. Informacion plotësues në lidhje me gjendjen familjare

#### *II. Gjendja financiare*

18. Profesioni

19. Emri dhe adresa e punëdhënësit ose vendi i ushtrimit të profesionit

20. Të ardhurat	e kërkuesit	të bashkëshortit	të personave në varësi të kërkuesit
a. Pagesa (përfshirë pagesat në natyrë)			
b. Pensionet, pensioni për paaftësi			

në punë, ndihma ekonomike për ish-bashkëshortin, ndihma financiare, pensioni vjetor			
c. Asistencë financiare për papunësi			
d. Të ardhura nga profesione që nuk shpërblehen me rrogë			
e. Të ardhura nga letrat me vlerë dhe kapitalet rrjedhëse			
f. Të ardhura nga pasuri të patundshme			
g. Burime të tjera të ardhurash			
21. Pasuri të patundshme	të kërkuesit	të bashkëshortit	të personave në varësi të kërkuesit
(lutemi shënoni vlerën(at) dhe detyrimet)			
22. Asete të tjera	të kërkuesit	të bashkëshortit	të personave në varësi të kërkuesit
(letra me vlerë, ndarje fitimesh, pretendime, llogari bankare, kapital biznesi etj.)			
23. Borxhe dhe detyrime të tjera financiare	të kërkuesit	të bashkëshortit	të personave në varësi të kërkuesit
a. Hua (deklaroni natyrën, shumën për t'u paguar dhe shlyerjet vjetore /mujore të borxhit)			
b. Detyrime për ushqim (deklaroni pagesat mujore)			
c. Qira shtëpie (duke përfshirë shpenzimet për ngrohje, energji elektrike, gaz dhe ujë)			
d. Detyrime të tjera periodike			
24. Tatimi mbi të ardhurat dhe kontributet mbi sigurimet shoqërore për vitin e kaluar			
25. Vërejtje të kërkuesit			
26. Nëse mundet, lista e dokumenteve plotësuese			
27 I nënshkruari, duke qenë plotësisht i vetëdijshëm për penalitetet e parashikuara nga ligji për dëshmi të rreme, deklaron se formulimi i mësipërm është i plotë dhe i saktë.			
28. Bërë në .....(vendi)                      29. Më.....(data)			
30 .....(Firma e kërkuesit)			